



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 30.05.2022

Dokument Parlamentar

RAPORT

Për shqyrtimin e kandidaturave për zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës së Shqipërisë, në votimin e raundit të tretë, datë 30 Maj 2022

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në seancat plenare të datave 16 maj 2022 dhe 23 maj 2022, përmbylli procedurat parlamentare për votimin e raundit të parë dhe të dytë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, të cilët rezultuan pa kandidatë.

Në zbatim të nenit 87, pika 2 e Kushtetutës dhe nenit 109, pika 3 e Rregullores së Kuvendit, u mbledh më datë 24.05.2022 Konferenca e Kryetarëve, e cila me vendimin nr. 12, datë 24.05.2022 caktoi datën 30.05.2022, ora 10.00, për zhvillimin e raundit të tretë të votimit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës. Sipas këtij vendimi, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, mbledhet më datë 30.05.2022, ora 09.00 dhe paraqet raportin e tij për seancë plenare deri në orën 10.00.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, u mbledh sot, më datë 30 maj 2022, ora 09.00, sipas afateve të caktuara nga Konferenca e Kryetarëve dhe bazuar të Rregulloren e Kuvendit, për shqyrtimin e kandidaturave të mundshme të depozituara në Kuvend.

Komisioni konstatoi se deri në afatin e përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve, për zhvillimin e raundit të tretë, asnjë kandidaturë për President nuk është depozituar në Kuvend.

Në këto kushte, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në zbatim të nenit 87, pika 2 të Kushtetutës, që përcakton se: ”Secili nga votimet e tjera zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga përfundimi pa sukses i votimit pararendës” dhe se “Votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat”, i paraqet seancës plenare që do të mbledhet

sot më datë 30 maj 2022, ora 10.00 sipas përcaktimeve ligjore, për informim raportin, me qëllim përmbylljen e procedurave për votimin e raundit të tretë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Relator

EDUARD NDRECA

Kryetare

KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)